



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi
Hetimore Unike**

**Ushtuesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(11) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 99 dhe 100 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ftoi ekipet e Mbrojtjes për të dorëzuar njoftime lidhur me çdo mundësi hetimore, sipas rregullës 99 të Rregullores, deri më 7 tetor 2022, dhe urdhëroi që kërkesat që përlligjin nevojën për masa të tilla të jenë dorëzuar deri më 28 tetor 2022.²

2. Më 7 tetor 2020, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“z. Thaçi” dhe “Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi një njoftim ku vinte në dukje se do të kërkojë masa për ruajtjen e provave të nëntë dëshmitarëve në kontekstin e një mundësie hetimore unike sipas rregullës 99 të Rregullores ose, si alternativë, deponimet sipas rregullës 100 të Rregullores (“Njoftimi”).³

3. Më 28 tetor 2022, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një Mocion i cili përlligjte nevojën për masat e kërkuara për tetë dëshmitarë në kuadër të një mundësie hetimore unike (“Mocioni”).⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1582, rreshti 21 deri në f. 1583, rreshti 6.

³ KSC-BC-2020-06, F01018, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 7 tetor 2022, publik, para. 16-17.

⁴ KSC-BC-2020-06, F01068, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes së Thaçit që Përlligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 28 tetor 2022, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 1 nëntor 2022, F01068/RED.

4. Më 10 nëntor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Mocionit ("Përgjigjja").⁵
5. Më 11 nëntor 2022, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një shtesë të Mocionit ("Shtesa"), ku përligjte nevojën për masat e kërkuara për dëshmitarin e nëntë.⁶
6. Më 15 nëntor 2022, Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").⁷
7. Po atë ditë, 15 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin që: (i) ZPS-ja t'i përgjigjej Shtesës; dhe (ii) Mbrojtja e Thaçit t'i kundërpërgjigjej përgjigjes së ZPS-së ndaj Shtesës.⁸
8. Më 18 nëntor 2022, ZPS-ja iu përgjigj Shtesës ("Përgjigjja ndaj Shtesës").⁹
9. Më 23 nëntor 2022, Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes ndaj Shtesës ("Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën").¹⁰

⁵ KSC-BC-2020-06, F01096, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 10 nëntor 2022, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-06, F01099, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtesë e Mocionit të Mbrojtjes së Thaçit që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 11 nëntor 2022, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 22 nëntor 2022, F01099/RED. Një version i korrigjuar u dorëzua më 24 Nëntor 2022, F01099/COR.

⁷ KSC-BC-2020-06, F01102, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionin e Mbrojtjes që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 15 nëntor 2022, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-06, F01103, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Ndryshimin e Afatit për Përgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Shtesës së Mocionit që Përligj Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 15 nëntor 2022, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F01112, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Shtesës së Mocionit të Thaçit për Mundësi Hetimore Unike*, 18 nëntor 2022, konfidenciale.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F01120, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Shtesën e Mocionit të Mbrojtjes që Përligj Kërkesën për Mundësi Hetimore Unike*, 23 nëntor 2022, konfidencial.

II. PARASHTRIMET

10. Mbrojtja e Thaçit argumenton se ekziston një mundësi hetimore unike në lidhje me nëntë¹¹ dëshmitarë ndërkombëtarë (“dëshmitarët”) provat e të cilëve, sipas saj, janë thelbësore për provat e Mbrojtjes dhe mund të mos jenë të disponueshme më pas gjatë gjykimit.¹² Mbrojtja e Thaçit pretendon se në kushte ideale do t’i thërriste dëshmitarët gjatë paraqitjes së provave prej saj, pas mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja.¹³ Sidoqoftë, duke pasur parasysh moshën e avancuar dhe gjendjet e ndryshme shëndetësore të dëshmitarëve, Mbrojtja e Thaçit parashtron se ekziston një rrezik shumë real që provat e tyre mund të mos jenë të disponueshme gjatë gjykimit në kohën që Mbrojtja do të nisë paraqitjen e provave të veta, ose për shkak të vdekjes apo për shkak të pamundësisë së dëshmitarëve për t’u paraqitur në gjyq.¹⁴ Mbrojtja e Thaçit argumenton se rrjedhimisht ekziston një mundësi hetimore unike dhe kërkon të ruajë provat e dëshmitarëve sipas rregullës 99 të Rregullores, ose si alternativë, të marrë deponimet e tyre sipas rregullës 100 të Rregullores (“masat e kërkuara”).¹⁵

11. Për sa i takon procedurës, Mbrojtja e Thaçit: (i) kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta ftojë Kryetaren të “caktojë të paktën një anëtar të Trupit Gjykses apo mundësisht, të tre anëtarët e tij për të ‘marrë pjesë’ në mundësinë hetimore unike për ruajtjen e këtyre provave përpara gjykimit”;¹⁶ dhe (ii) propozon që, nëse dëshmitarët janë në gjendje të mirë për të udhëtuar, dëshmitë e tyre të merren në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHS”) në prani të të akuzuarit (“masa e parë”).¹⁷ Mbrojtja e Thaçit

¹¹ Mocioni, para. 9, 11; Shtesa, para. 2.

¹² Njoftimi, para. 5-6; Mocioni, para. 16; Shtesa, para. 14, 20.

¹³ Njoftimi, para. 16; Mocioni, para. 16; Shtesa, para. 21.

¹⁴ Njoftimi, para. 6; Mocioni, para. 16.

¹⁵ Njoftimi, para. 5, 16-17; Mocioni, para. 1, 9, 12-14, 37-38; Shtesa, para. 9, 11-12, 21-22.

¹⁶ Njoftimi, para.11. *Shih gjithashtu*, Njoftimin, para. 5, 10, 12; Mocioni, para. 13.

¹⁷ Njoftimi, para. 13; Mocioni, para. 13; Shtesa, para. 11, 16. *Shih gjithashtu*, Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, poshtëshënimi 1.

parashtron se zbatimi i masës së parë do të: (i) mundësojë pyetje për dëshmitarët nga Mbrojtja, pyetje të mundshme shtesë nga mbrojtjet e të akuzuarve të tjerë, nga ZPS-ja, Mbrojtësi i Viktimave dhe nga Trupi Gjykses;¹⁸ dhe do të (ii) garantojë të drejtën themelore të z. Thaçi për gjykim të drejtë për të mundësuar praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tij “në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij”.¹⁹

12. Mbrojtja e Thaçit jep identitetin, përshkrimin, moshën, vendndodhjet dhe deklaratën e temave për të cilat do të pyetet secili prej dëshmitarëve.²⁰ Ajo argumenton se dëshmitarët: (i) kanë qenë të gjithë diplomatë, administratorë apo figura ushtarake në moshë të vjetër dhe me rang të lartë në organizata të ndryshme në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës; (ii) kanë komunikuar me z. Thaçi në nivel profesional dhe, në disa raste, në nivel personal; (iii) do të dëshmojnë për aspekte thelbësore për çështjen;²¹ dhe (iv) do të japin dëshmi nga më të rëndësishmet që DHS-ja do të dëgjojë në këtë çështje.²² Mbrojtja e Thaçit pretendon se humbja e dy dëshmitarëve të mundshëm demonstroi nevojën për ruajtjen e provave të dëshmitarëve.²³ Ajo parashtron se vlerësimi se kur do të fillojë paraqitja e provave nga Mbrojtja dhe mosha që do të kenë dëshmitarët në atë kohë është një parametër tjetër kritik i cili duhet marrë parasysh.²⁴

13. Mbrojtja e Thaçit e fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të ketë parasysh praktikën gjyqësore të tribunalëve *ad-hoc* në lidhje me deponimet, e cila tregon se koha deri kur Mbrojtja do të ketë gjasa për t’u dëgjuar dhe mosha e dëshmitarëve

¹⁸ Njoftimi, para. 16; Mocioni, para. 13; Shtesa, para. 11.

¹⁹ Njoftimi, para. 16; Mocioni, para. 25, 28-29. *Shih gjithashtu*, Shtesën, para. 14.

²⁰ Mocioni, para. 9, 11; Shtojcat 1-8 të Mocionit; Shtesa, para. 14, 19-20; Shtojca 1 e Shtesës.

²¹ Mocioni, para. 15; Shtesa, para. 13, 19-20.

²² Mocioni, para. 15; Shtesa, para. 20.

²³ Mocioni, para. 16.

²⁴ Mocioni, para. 17-25.

janë faktorë që meritojnë dhënien e deponimeve me qëllim ruajtjen e provave që ndryshe do të ishin të padisponueshme.²⁵

14. Si alternativë, dhe për të njëjtat arsye mbi të cilat mbështetet kërkesa për masën e parë, sipas rregullës 99 të Rregullores, Mbrojtja e Thaçit e fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të ruajë provat e këtyre dëshmitarëve përpara gjykimit përmes deponimeve të tyre sipas rregullës 100 të Rregullores (“masa alternative”).²⁶ Mbrojtja e Thaçit parashton se, ndryshe nga masa e parë, masa alternative nuk do të garantonte të drejtën e z. Thaçi për mundësimin e pranisë dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tij “në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij”.²⁷

15. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni dhe Shtesa duhen rrëzuar sepse masat e kërkuara nuk kanë bazë ligjore dhe justifikim të përshtatshëm.²⁸ ZPS-ja pretendon se mosha e dëshmitarëve dhe kohëzgjatja e mundshme e paraqitjes provave nga ZPS-ja – pa argumente të tjera – janë të pamjaftueshme për të përligjur mundësitë hetimore unike sipas rregullës 99 të Rregullores, ose marrjen e deponimeve sipas rregullës 100 të Rregullores.²⁹ ZPS-ja parashton se masa e parë – pra, dëgjimi i dëshmitarëve nga gjykatësit e trupit gjykues që nuk është caktuar ende – duhet të hidhet poshtë menjëherë, sepse tejkalon kompetencën e dhënë Gjykatësit të Procedurës Paraprake duke qenë se: (i) Kryetarja emëron një trup gjykues me kalimin e dosjes së çështjes trupit gjykues; dhe (ii) paraqitja e provave më vonë është në kompetencën e trupit gjykues.³⁰ ZPS-ja argumenton më tej se Mocioni nuk arrin të demonstrojë: (i) se provat e dëshmitarëve mund të mos jenë të disponueshme gjatë gjykimit;³¹ dhe (ii) se masat e kërkuara janë të domosdoshme

²⁵ Mocioni, para. 26.

²⁶ Njoftimi, para. 15, 17; Mocioni, para. 14, 27; Shtesa, para. 12, 22.

²⁷ Mocioni, para. 28-29.

²⁸ Përgjigjja, para. 1, 3-5; Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 1, 4.

²⁹ Përgjigjja, para. 1, 3-5; Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 4.

³⁰ Përgjigjja, para. 2; Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 3.

³¹ Përgjigjja, para. 4-5.

sepse, sipas saj, asnjë rrethanë unike nuk përlligj devijim nga procedura e zakonshme dhe se Mbrojtja nuk tregon se ka ndërmarrë hapat e mundshëm brenda kornizës ligjore për të ruajtur provat e dëshmitarëve.³² ZPS-ja shprehet se sjellja e Mbrojtjes e hedh poshtë pretendimin se është urgjente të dëgjohen dëshmitarët.³³ Së fundi, ZPS-ja kundërshton karakterin e pretenduar “thelbësor” të dëshmisë të dëshmitarëve. Për mendimin e ZPS-së, kontaktet profesionale dhe në disa raste, të ngushta personale të dëshmitarëve me z. Thaçi nuk i bëjnë domosdoshmërisht deponimet e tyre me rëndësi themelore. Përkundrazi, sipas ZPS-së, provat e pritshme nga disa dëshmitarë kanë relevancë të paktë.³⁴ ZPS-ja vjen në përfundim se, për mendimin e saj, Mocioni është një tentativë për ta kthyer mbrapsht rendin e paraqitjes së provave të parashikuar nga Rregullorja.³⁵

16. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se ZPS-ja e keqkupton masën e parë të kërkuar prej saj: ajo nuk kërkon që çështja t’i kalohet trupit gjykues; por, që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta ftojë Kryetaren të emërojë një gjykatës, apo një panel gjykatësish, për të dëgjuar dëshmitarët në kontekstin e një mundësie hetimore unike, si një detyrë e veçantë, sikundër përcaktohet në rregullën 99(3)(a) të Rregullores.³⁶ Megjithatë, Mbrojtja e Thaçit sugjeron se gjykatësi (gjykatësit) më të përshtatshëm për të dëgjuar dëshmitë janë gjykatësit që do të përbëjnë trupin gjykues që do të caktohet për të dëgjuar çështjen në gjykim.³⁷ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se ZPS-ja e shtrembëron standardin ligjor të propozuar: ndonëse mosha e dëshmitarëve në vetvete nuk është një arsye e mjaftueshme, ajo parashtron se mosha e dëshmitarëve bashkë me kohëzgjatjen e përlllogaritur të paraqitjes së provave nga ZPS-ja mund të jenë arsye të mjaftueshme për të besuar

³² Përgjigjja, para. 6-8.

³³ Përgjigjja, para. 9.

³⁴ Përgjigjja, para. 10; Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 4.

³⁵ Përgjigjja, para. 11.

³⁶ Kundërpërgjigjja, para. 5. *Shih gjithashtu*, Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, para. 7.

³⁷ Kundërpërgjigjja, para. 5. *Shih gjithashtu*, Kundërpërgjigjen lidhur me Shtesën, para. 7.

se provat e dëshmitarëve mund të bëhen të padisponueshme.³⁸ Lidhur me argumentin e ZPS-së se Mbrojtja e Thaçit nuk i shteroi të gjitha mjetet juridike në dispozicion të saj, si intervistimi i dëshmitarëve prej saj, që më vonë të mund të kërkonte pranimin e provave të dëshmitarëve sipas rregullave 153-155 të Rregullores, Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se rregulla të tilla me gjasë nuk do të ndihmojnë, duke qenë se provat e dëshmitarëve kanë të bëjnë me veprimet dhe sjellën e të akuzuarit.³⁹ Mbrojtja e Thaçit argumenton se marrja e masës së parë në shkurt dhe prill 2023 nuk do ta dëmtojë ZPS-në dhe vonojë dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së.⁴⁰ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit hedh poshtë parashtrimet e ZPS-së se Mocioni u paraqit me vonesë, duke vënë në dukje se ajo veproi në pajtim me afatin e vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴¹

17. ZPS-ja në Përgjigjen e saj ndaj Shtesës përgjigjet se Shtesa u dorëzua pas afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe se nuk u bë asnjë kërkesë për ndryshimin e afatit sipas rregullës 9(5) të Rregullores.⁴² ZPS-ja argumenton gjithashtu se Shtesës i mungon themelësia, duke qenë se ka të njëjtat mangësi si Mocioni.⁴³

18. Në kundërpërgjigjen e saj lidhur me Shtesën, Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Shtesa nuk u dorëzua jashtë afatit. Ajo argumenton se: (i) ZPS-ja dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishin të njoftuar për kërkesën që pritej të bëhej në lidhje me dëshmitarin e nëntë brenda afatit të përcaktuar; dhe se (ii) ajo e dorëzoi Shtesën sapo që mori miratimin nga autoritetet përkatëse.⁴⁴ Mbrojtja e Thaçit pretendon se masa e parë nuk i tejkalon kompetencat e dhëna Gjykatësit të Procedurës Paraprake, sepse e drejta e Kryetares për emërimin e një gjykatësi, me

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 6-7.

³⁹ Kundërpërgjigjja, para. 8-11.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 12.

⁴¹ Kundërpërgjigjja, para. 14.

⁴² Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 2.

⁴³ Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 3-5.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 5.

ftesë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për qëllimin e Masës së Parë, përcaktohet qartë në rregullën 99(3)(a) të Rregullores.⁴⁵

19. Mbrojtja e Thaçit gjithashtu mendon se mosha dhe kohëzgjatja e përllogaritur e paraqitjes së provave nga ZPS-ja *së bashku* mund të jenë një arsye që provat mund të bëhen të padisponueshme.⁴⁶ Mbrojtja e Thaçit argumenton konkretisht se nuk mund të mohohet se deponimi i dëshmitarit të nëntë mund të bëhet i pamundur për shkak të vdekjes apo pamundësisë së tij për shkak të moshës së vjetër në kohën që ai mund të pritet të dëshmojë.⁴⁷ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashton se rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit të nëntë është e qartë, duke pasur parasysh, ndër të tjera, rolin e tij në kohën përkatëse.⁴⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

20. Në bazë të nenit 39(11) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të përcaktojë, nëse është e nevojshme, ndër të tjera, ruajtjen e provave.

21. Sipas rregullës 99(1) të Rregullores, kur palët janë të mendimit se hetimi paraqet një mundësi unike për të marrë dëshmi nga një dëshmitar apo për të shqyrtuar, mbledhur apo verifikuar provat të cilat mund të mos jenë të disponueshme më pas në gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me kërkesën e një pale, mund të marrë masa të domosdoshme për garantimin e ruajtjes së provave.

22. Sipas rregullës 100(1) të Rregullores, kur ka arsye për të besuar se dëshmia e një dëshmitari të mundshëm mund të bëhet përndryshe e padisponueshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të vendosë, *proprio motu*, ose me kërkesën e një pale, që deponimi të merret për t'u përdorur në gjykim, pavarësisht nëse

⁴⁵ Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 7.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 8-9.

⁴⁷ Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 9.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja lidhur me Shtesën, para. 10.

personi të cilit i kërkohet deponimi është apo jo në gjendje të paraqitet personalisht para DHS-së për dëshmuar.

23. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, trupi gjykues, *proprio motu* ose pasi t'i jenë treguar arsye të vlefshme, mund ta zgjasë afatin e vendosur prej tij apo të gjykojë të vlefshëm çfarëdo veprimi të ndërmarrë pas përfundimit të afatit përkatës.

IV. DISKUTIM

A. DORËZIMI I SHITESËS BRENDA AFATIT

24. Për sa i takon argumentit të ZPS-së se Shtesa duhet rrëzuar për shkak të dorëzimit jashtë afatit,⁴⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se ka urdhëruar ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë çdo kërkesë që përlijt nevojën për ndonjë mundësi hetimore sipas rregullës 99 të Rregullores deri më 28 tetor 2022.⁵⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit e dorëzoi Shtesën më 11 nëntor 2022 pa bërë ndonjë kërkesë për ndryshimin e afatit.

25. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se Mbrojtja e Thaçit: (i) e bëri të njohur synimin e vet për të kërkuar masa sipas rregullës 100 të Rregullores, në lidhje me nëntë persona qysh me dorëzimin e Njoftimit më 7 tetor 2022;⁵¹ (ii) shpjegoi se, në datën e dorëzimit të mocionit, “për arsye që nuk vareshin prej saj” mund të kërkonte masa vetëm për tetë dëshmitarë;⁵² dhe (iii) shpjegoi se, në kohën e dorëzimit të Shtesës, duke qenë se sapo e kishte marrë miratimin e autoriteteve përkatëse, tani ishte në gjendje të kërkonte masa për dëshmitarin e nëntë, të përmendur fillimisht në Njoftim.⁵³ Duke pasur parasysh këto rrethana konkrete, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i bindur se dorëzimi me

⁴⁹ Përgjigjja ndaj Shtesës, para. 2.

⁵⁰ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 8 shtator 2022, publik, f. 1582, rreshti 21 deri në f. 1583, rreshti 6.

⁵¹ Njoftimi, para. 5.

⁵² Mocioni, para. 9.

⁵³ Shtesa, para. 2.

vonesë i Shtesës ishte jashtë kontrollit të Mbrojtjes së Thaçit. Për më tepër, ZPS-ja nuk dëmtohet prej kësaj gjëje, duke qenë se : (i) ishte njoftuar për synimin e Mbrojtjes së Thaçit për kërkimin e masave për nëntë dëshmitarë; dhe (ii) ishte në gjendje t'i përgjigjej plotësisht Shtesës. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i hedh poshtë parashtrimet e ZPS-së në këtë drejtim.

26. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranon dorëzimin me vonesë së Shtesës.

B. MASA E PARË

27. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se rregulla 99 e Rregullores përcakton që hetimi duhet të paraqesë një mundësi unike për shkak se dëshmia mund të mos jetë e disponueshme më vonë gjatë gjykimit. Rrjedhimisht, standardi ligjor i kësaj dispozite ka të bëjë me disponueshmërinë e një veprimi hetimor i cili paraqet një mundësi unike për sigurimin e provave që mund të mos jenë të disponueshme më vonë gjatë gjykimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se vlerësimi nëse dëshmia mund "të mos jetë e disponueshme më vonë gjatë gjykimit" bëhet rast pas rasti dhe përfshin marrjen në shqyrtim të faktorëve të tillë si, ndër të tjerë, kalimi i kohës, gjendja shëndetësore apo fizike e dëshmitarit, qasja në kohë në materialin provues, ose trysnia e ushtruar ndaj një dëshmitari.⁵⁴ Krahas standardit ligjor të përmendur më sipër, Gjykatësi i

⁵⁴ *Shih p.sh., ICC, Prosecutor v. Ongwen, ICC-02/04-01/15-316, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the "Second Prosecution Application to the Pre-Trial Chamber to Preserve Evidence and Take Measures Under Article 56 of the Rome Statute"](#), 23 March 2016, publik, para. 9; Prosecutor v. Ongwen, ICC-02/04-01/15-277, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the Prosecution Application to the Pre-Trial Chamber to Preserve Evidence and Take Measures Under Article 56 of the Rome Statute](#), 27 July 2015, publik redacted, para. 7, 14. Shih gjithashtu, Prosecutor v. Al Hassan, ICC-01/12-01/18-204, [Décision relative aux requêtes du Procureur aux fins de prendre des mesures nécessaires en application de l'article 56-2 du Statut pour les témoins MLI-OTP-P-0066, MLI-OTP-P-0004, MLIOTP-P-0605, MLI-OTP-P-0582 et MLI-OTP-P-0537](#), 13 December 2018, publik, para. 44; Prosecutor v. Al Hassan, ICC-01/12-01/18-232, Pre-Trial Chamber I, [Décision relative à la requête du Procureur aux fins de prendre des mesures nécessaires en application de l'article 56-2 du Statut pour le témoin MLI-OTP-P-0065](#), 30 January 2019, publik, para. 18; Prosecutor v. Ongwen, ICC-02/04-01/15-520,*

Procedurës Paraprake është i mendimit se rregulla 99 e Rregullores nënkupton se veprimi i kërkuar hetimor duhet të jetë relevant për përgatitjen e argumenteve të palës kërkuese. Së fundi, masat e marra sipas rregullave 99 dhe 100 të Rregullores nuk përjashtojnë që më vonë palët të kërkojnë pranimin në gjykim të deklaratave të mëparshme me shkrim apo të transkripteve, në përputhje me rregullat 153 deri në 155 të Rregullores.

28. Në lidhje me argumentet e Mbrojtjes së Thaçit për sa u takon dëshmitarëve (“mosha e avancuar” dhe “gjendjet e ndryshme shëndetësore”), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se dëshmitarët janë të moshës 77 deri në 87 vjeç. Megjithatë, asgjë në Mocion apo në Shtesë nuk tregon se gjendja shëndetësore e dëshmitarëve aktualisht përbën ndonjë shqetësim serioz që do të përlligjte ruajtjen e menjëhershme të dëshmimeve të tyre. Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit pranon se shëndeti i dobët ose i keq i dëshmitarëve “aktualisht nuk është një faktor që luan ndonjë rol në këtë rast”.⁵⁵ Sikurse Mbrojtja e Thaçit ka pranuar,⁵⁶ mosha në vetvete nuk është një arsye e mjaftueshme për të besuar se dëshmia e një dëshmitari mund të bëhet e padisponueshme.

29. Në lidhje me kohëzgjatjen e pritshme të fillimit të mundshëm të paraqitjes së provave nga Mbrojtja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se do t’ia kalojë çështjen një trupi gjykues nga fundi i vitit 2022.⁵⁷ Rrjedhimisht, një trup gjykues

Trial Chamber IX, [Decision on Request to Admit Evidence Preserved Under Article 56 of the Statute](#), 10 August 2016, publik, para. 9; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11, Trial Chamber V, [Konfidencial Redacted Version Decision on the Prosecution’s Application Në bazë të nenit 56](#), 18 January 2013, konfidencial, para. 17; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-491, Trial Chamber V, [Order regarding ‘Prosecution’s application në bazë të nenit 56’](#), 29 Nëntor 2012, publik, para. 3; ICC-01/04-93, Pre-Trial Chamber I, [Decision following the Consultation held on 11 Tetor 2005 and the Prosecution’s Submission on Jurisdiction and Admissibility filed on 31 Tetor 2005](#), 9 Nëntor 2005, publik; see also *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-126, Pre-Trial Chamber I, [Decision to Hold Consultations Under Rule 144](#), 28 April 2011, public.

⁵⁵ Mocioni, para. 26; Kundërpërgjigjja, para. 6.

⁵⁶ Kundërpërgjigjja, para. 6.

⁵⁷ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 4 nëntor 2022, publik, f. 1587, rreshti 22 deri në f. 1588, rreshti 2.

gjithsesi do të angazhohet me procedimin e kësaj çështjeje shumë më herët se masa e parë e parashikuar nga Mbrojtja e Thaçit për në shkurt 2023 të mund të jetë realisht e zbatueshme, në rast se miratohet. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kalimin së afërmi të çështjes për gjykim dhe caktimin e pritshëm më pas të trupit gjykues, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se vlerësimi i relevancës, rëndësisë, nevojës dhe planifikimit të deponimit të dëshmitarëve është diçka për të cilën vendos më së miri trupi gjykues që do të caktohet për të gjykuar çështjen.

30. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit nuk ka mundur ta faktojë kërkesën e vet për një mundësi hetimore unike dhe e hedh poshtë kërkesën lidhur me masën e parë.

31. Pavarësisht nga kjo, ky vendim nuk cenon asnjë parashtrim në lidhje me modalitetet, kohën dhe kronologjinë e deponimit të dëshmitarëve, që mund t'i paraqitet në të ardhmen trupit gjykues që do të ngarkohet me këtë çështje.

C. MASA ALTERNATIVE

32. Standardi ligjor sipas rregullës 100 të Rregullores për marrjen e një dëshmie deponuese për përdorim në gjykim është nëse “ka arsye të besohet se dëshmia e një dëshmitari të mundshëm përndryshe mund të bëhet e padisponueshme”.

33. Për arsyet e përshkruara më lart,⁵⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është bindur se mosha e avancuar dhe gjendjet e ndryshme shëndetësore të dëshmitarëve dhe kohëzgjatja e pritshme para fillimit të dëgjimit të provave të mbrojtjes përbëjnë në këtë fazë një arsye për të besuar se dëshmitë e dëshmitarëve mund të bëhen të padisponueshme, sipas kuptimit të rregullës 100 të Rregullores.

⁵⁸ *Shih më lart*, para. 28-29.

34. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzon Kërkesën për Masë Alternative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se Mbrojtja e Thaçit nuk përjashtohet nga bërja e parashtrimeve para trupit gjykues përkatës në lidhje me dëshmitarët, nëse dëshiron ta bëjë.

V. KLASIFIKIMI

35. Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve,⁵⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron: (i) Administratoren të riklasifikojë Kundërpërgjigjen (F01102) dhe Përgjigjen ndaj Shtesës (F01112) si publike; (ii) ZPS-në të dorëzojë një version të redaktuar publik të Përgjigjes (F01096), duke redaktuar identitetet e dy dëshmitarëve të përmendur me emër në paragrafin 10; dhe (iii) Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes lidhur me Shtesën (F01120), duke redaktuar identitetin dhe informacionin personal të dëshmitarit të propozuar në paragrafët 1, 8-10 dhe në poshtëshënimin 21.

⁵⁹ Përgjigja, para. 12; Kundërpërgjigja, para. 4; Përgjigja ndaj Shtesës, para. 6; Kundërpërgjigja lidhur me Shtesën, para. 4.

VI. VENDIM

36. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **E RRËZON** Mocionin; dhe
- (b) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Kundërpërgjigjen (F01102) dhe Përgjigjen ndaj Shtesës (F01112) si publike deri të **hënën, 5 dhjetor 2022;**
- (c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë një version të redaktuar publik të Përgjigjes (F01096), sikurse përcaktohet në paragrafin 35 më lart, deri të **hënën, 5 dhjetor 2022;**
- (d) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kundërpërgjigjes lidhur me Shtesën (F01120), sikurse përcaktohet në paragrafin 35 më lart, deri të **hënën, 5 dhjetor 2022.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 28 nëntor 2022

Në Hagë, Holandë.